



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dorezimi / Prilipje / Pristava / Received / Delivered	11. 02 2021	1	viti god year
Organ / Agjencia Organ / Agencija / Org / Inst	No Prot No Prot Prot No	Shtypja Printig Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM8HCK	599/2021		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A. Nr. 416/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi- Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani, dhe Jeton Koci, anëtarë, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr.416/2020, të datës 14.12.2020, së ankueses me adresë banimi f.sh Ndërkombëtarë nr. 98, nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridik "transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 11.02.2021, mori këtë;

V E N D I M

- I. APROVOHET** pjesërishtë si e bazuar ankesa me numër A. Nr. 416/2020, e datës 14.12.2020, e parashtruar nga ankuesja
- II. SHFUQIZOHET** Vendimi me numër protokoll 227, i datës 08.12.2020, i Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
- III. OBLIGOHET** Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për zbatimin e këtij vendimi, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke e sistemuar ankuesen në ndonjë nga tri pozitat e lira udhëheqëse që janë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.
- V.** Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i Kolegjit.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 25.11.2020, ka nxjerr vendim me Nr. A. 296/2020, me të cilin ka shfuqizuar Vendimin e datës 18.09.2020, me numër protokoll Nr. Ref.161/2020i të Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me qëllim të Zbatimit të Vendimit numër A. 296/2020 të datës 25.11.2020, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 08.12.2020, ka nxjerr vendim me numër reference 227/2020, me të cilin ankuesen e ka sistemuar përkohësisht në pozitën „Zyrtarë e Lartë për Çështje Politike”, në Departamentin për Çështje Politike.

Ankuesja e pakënaqur me vendimin me numër reference 227/2020, të datës 08.12.2020, të Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datën 14.12.2020, ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3118/2020, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër A nr. 416/2020, të datës 14.12.2020, me numër protokoll 3118/2020, të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 08.12.2020, të Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin me numër A. Nr. 296/2020 të datës 25.11.2020, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimi i datës 30.05.2014; Ndryshimi dhe plotësimi i Akt Emërimit; Vendimi i datës 18.09.2020; Vendimi i datës 10.02.2016; Vendimi i datës 10.07.2020; Përgjigje në ankesë e datës 28.10.2020, me numër protokoll 2312/2020, me shkresat e bashkangjitura: Vendimin VK.nr.8/2021 të datës 28.01.2021 për vazhdimin e afatit të vendosjes, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Emali zyrtar i datës 01.02.2021 ku konfirmohen pozitat e lira udhëheqëse në kuadër të MPJD.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e bazuar pjesërisht sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses lidhur me sistemimin e përkohshëm në pozitën „Zyrtarë e Lartë për Çështje Politike”, pas kthimit nga misioni nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Romë/ Itali ku ankuesja ka qenë me gradën diplomatike „Këshilltarë”, si dhe moszbatimin e vendimit të Këshillit ka konstatuar se pretendimi ankimor është i bazuar sepse Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka vërtetuar se Vendimi me numër reference 227/2020 i datës 08.12.2020, i Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, është nxjerr duke u bazuar në nenin 23 paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës si dhe nenin 52 paragrafin 1.1 të Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: **“1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve”,** rrjedhimisht nga kjo Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, vendimin për sistemim të përkohshëm e ka nxjerr në kundërshtim me nenin 52 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, pasi që ankuesja nuk është transferuar në pozitë të shërbimit civil të së njëjtës kategori, pasi që duke u bazuar në ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit me numër Nr.139/2013 të datës 13.08.2014 ankuesja para se të caktohet në mision diplomatik kishte qenë në pozitën:

“Udhëheqëse e Departamentit për Çështje Politike”, sipas legjislacionit në fuqi të shërbimit civil respektivisht duke pasur parasysh dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ankuesja është degraduar, dhe rrjedhimisht nga ky konstatim mbi bazë të provave që kemi pasur në dispozicion të ofruar nga vetë palët vendimi i datës 08.12.2020, me Nr.Ref.227/2020 konsiderohet i paligjshëm dhe nuk mund të prodhoj asnjë efekt juridik, andaj vendimi i Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është në kundërshtim me nenin 52 pika 1.1 e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji konstaton se Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes vendimit të datës 08.12.2020, me Nr.Ref.227/2020 në asnjë mënyrë nuk ka vërtetuar faktin se sistemimi i përkohshëm është bërë për interes të institucionit siç parashohin dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë sepse, paragrafi 1.1 i nenit 52 të këtij ligji është i ndërlidhur me paragrafin 1 të këtij neni, i cili parashihet 'Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori'.

Ndërsa po ashtu arsyetimi i vendimit të sistemimit të përkohshëm është shumë kundërtshëm në vetë përmbajtjen e tij nga se në pjesën e epërme të arsyetimit i referohet interesit të institucionit me rastin e sistemimit të përkohshëm ndërsa në pjesën e fundit të arsyetimit konstatohet se kjo pozitë ka qenë e lire dhe për këtë arsye është vendosë përkohësisht, që në fakt nuk ka asnjë argument që vërteton rrethanën e mbizotërimit të parimit të interesit të institucionit me rastin e vendosjes së përkohshme në këtë pozitë andaj edhe sa i përket kësaj çështje ky vendim nuk është në përputhje me dispozitat e LPPA Nr.05/L-031.

Kolegji me qëllim të vendosjes meritore lidhur me ankesën e ankueses dhe ndërlidhur me konstatimin e mësipërm, me datë 28.01.2021 ka kërkuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës organogramin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës si dhe pozitat e lira udhëheqëse në kuadër të Ministrisë. Këshilli me datë 01.02.2021 ka pranuar përgjigjen me prova shtesë nga udhëheqësja e personelit në MPJD, e cila ka theksuar se: "Pozitat e lira aktuale në kuadër të MPJD janë: Udhëheqës i Divizionit për Traktate, Udhëheqës i Divizionit për Politika Konsullore si dhe Udhëheqës i Divizioni të Personelit". Me rastin e zbatimit të këtij vendimi Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë është i obliguar që ankuesen ta sistemoj në ndonjërin nga tri pozitat e lira udhëheqëse në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se, neni 4 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë përcakton se: "*Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë*", si dhe paragrafi 2 i Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "*2. Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve*", rrjedhimisht nga kjo Kolegji konstaton se Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ia ka njohur të drejtën Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që me rregulla të brendshme të rregulloj transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve të Ministrisë, por që nga analizimi i legjislacionit dhe rregulloreve të Ministrisë së Punëve të

Jashtme dhe Diasporës, por edhe nga referimi që i është bërë dispozitave të nenit 52 paragrafin 1.1 të Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me rastin e nxjerrjes së vendimit të datës 08.12.2020, me Nr.Ref.227/2020, konstatohet se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës nuk ka rregulla të veçanta që e rregullojnë transferimin, respektivisht sistemimin e diplomatëve të cilët e përmbushin afatin kohor për shërbim jashtë vendit dhe kthehen për shërbim në Ministri, rrjedhimisht nga kjo lidhur me transferimin apo sistemimin e nëpunësve të Ministrisë, vlejné dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji me rastin e aprovimit të pjesshëm të ankesës ka pasur parasysh edhe faktin se përveç që me Ligj dhe akte nënligjore të MPJD-së, nuk është e rregulluar kjo çështje e sistemimit të përkohshëm me rastin e kthimit apo tërheqjes nga misioni diplomatik, poashtu edhe me legjislacionin në fuqi të zyrtarëve publik nuk është rregulluar çështja sa i përket sistemimit të përkohshëm në situatat kur nuk

ka pozita të lira ekuivalente të kategorisë së njëjtë, nga se kjo është e rregulluar vetëm për pozita të nivelit të lartë drejtues.

Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke pasur parasysh shkresën zyrtare/e-mailin e datës 01.02.2021 nga MPJD, në mungesë të pozitave ekuivalente të lira brenda institucionit konstaton se është obligim i institucionit në këtë rast MPJD-së që ankuesen ta sistemoj në ndonjë pozitë të lirë brenda

institucionit, që në fakt janë pozita të nivelit të ulët drejtues, përderisa MPJD konformë Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë, neni 4 paragrafi 1 dhe 2 nuk rregullon me Ligj të veçantë dhe me akte nënligjore ndërlidhur me këtë nenë çështjet që janë objekt i kësaj ankese.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

***Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 416/2020***

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Ministrin të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Sekretarin të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

